

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Talents International Kids Store Investments Kft., me seli të regjistruar në adresën Váci utca 38, 1056 Budapest, Hungari, të dorëzuar përmes Lupka Noveska Andonova, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 25.03.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin shoqëria Talents International Kids Store Investments Kft., me seli të regjistruar në adresën Váci utca 38, 1056 Budapest, Hungari, do të fitojë kontroll të pavarur mbi ALFI KIDS, menaxhim i investimeve, sh.p.k., me seli të regjistruar në rrugën Verovškova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 26.01.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), më datë 04.02.2026, ndërsa e plotësuar më 03.03.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga shoqëria Talents International Kids Store Investments Kft., me seli të regjistruar në adresën Váci utca 38, 1056 Budapest, Hungari, me të cilin Talents International Kids Store Investments Kft. do të fitojë kontroll të pavarur mbi ALFI KIDS, menaxhim i investimeve, sh.p.k., me seli të regjistruar në rrugën Verovškova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, shtojcave dhe plotësimeve të tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

-Talents International Kids Store Investments Kft. është shoqëri me qëllim të posaçëm, e themeluar në dhjetor të vitit 2025 për qëllime të pjesëmarrjes në transaksionin e propozuar dhe aktualisht nuk ka aktivitete afariste. Në mënyrë indirekte është në pronësi të plotë dhe nën kontroll të pavarur të Grupit Mészáros.

Grupi Mészáros përfshin shoqëri të varura që veprojnë në sektorë të ndryshëm, të cilët përbëjnë pjesë përbërëse të një nëngrupi në kuadër të një grupi më të gjerë. Këto nëngrupe kryesisht merren me ndërtimtari, patundshmëri, inxhinieri, transport, energjetikë, bujqësi dhe hotelieri.

Grupi Mészáros nuk ka shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut. Megjithatë, Grupi Mészáros ka realizuar të ardhura të vogla në Maqedoninë e Veriut gjatë vitit 2024 përmes shoqërive të grupit që nuk janë të regjistruara në Maqedoninë e Veriut. Pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave është realizuar përmes shitjes së niseshtesë dhe produkteve me bazë niseshteje, si dhe përmes veprimtarisë hoteliere dhe aktiviteteve të lidhura me turizmin, duke përfshirë shërbimet e akomodimit dhe rekreacionit.

-ALFI KIDS, menaxhim i investimeve, sh.p.k., është shoqëri holding dhe, së bashku me subjektet që janë nën pronësinë e saj të plotë dhe kontrollin e saj të pavarur, përbën Grupin e Shoqërive ALFI KIDS („Grupi ALFI KIDS“).

Subjektet në Grupin ALFI KIDS zhvillojnë dhe menaxhojnë veprimtari afariste të shitjes me pakicë dhe shumicë të produkteve për nëna dhe produkteve për fëmijë deri në moshën 8-vjeçare. Grupi ALFI KIDS është aktiv në shitjen me pakicë vetëm në Slloveni, Kroaci dhe Maqedoninë e Veriut, ndërsa ushtron tregti me shumicë në më shumë se 20 shtete.

Grupi ALFI KIDS ka vetëm një shoqëri të varur në Maqedoninë e Veriut – APOLLO MK SHPKNJP Shkup, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli të regjistruar në bulevardin „Kiro Gligorov“ nr. 13, Shkup – Gazi Babë, Maqedonia e Veriut, e cila është aktive në shitjen me shumicë dhe pakicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesorëve për fëmijë dhe produkteve tekstile për fëmijë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimet të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ